

PËRDORIMI I MJETEVE PERSONALE MBROJTËSE

- Rrobat e punës nga materiali i lehtë (fije natyrale, pambuku, len), e gjatë punës në hapësirë të hapur, në kushte të shfqujshëm në rrëze dielli të përdoren krema për rrezitje me faktor mbrojtës (30 apo më shumë)

EDUKIMI PËR NDIHMË TË PARË NË VENDIN E PUNËS

- Njohje të simptomave për goditje nga vala e nxehëtë (lodhje, mali, kokëdhimbje, marramendje, zbehje, vjellje, shqetësim, huti, kolaps, shok) vetparaqitje të simptomave, kujdes për kolegët
- Ata të cilët kanë simptome nuk lejohen të shkojnë në shtëpi, përderisa nuk stabilizohen (numri më i madh i rasteve të vdekjeve nga vala e nxehëtë ndodhin në rrugë për në shtëpi;

Në pajtueshmëri me rregullativën ligjore, patjetër nevojitet edukim i punëtorëve të caktuar për dhënien e ndihmës së parë. Punëtor i cili ka vështirësi shëndetësore për shkak të shfaqjes së temperaturave të larta, menjëhere duhet te largohet në "strehimore" – ne hapësirë ftohur apo të klimatizuar, ose në qoftë se nuk ka tjetër mundësi nën hije. Është e domosdoshme që punëtori të ftohet me heqjen e veshjes së tepeërt, stërpikje me ujë (temperaturë dhome), ftohje (ne qoftë se ka) me fluturushkë (ventilator), duke vënë fasha të ftohta në kokë (në ballë, rrëth qafës).

Në qoftë se punëtori është i vetëdijshëm, duhet të vihet në pozitë të shtirë në shpinë, këmbët t'ingrihen lartë dhe t'i jipet sa më shumë lëngje të pijë. Në qoftë se nuk është i vetëdijshëm, punëtori kthehet në pozitë anësore dhe menjëherë kërkohet ndihma mjekësore me thirje 194, e cila do të sigurojë ndihmë profesionale mjekësore dhe nëse është e nevojshme transport në objektin e duhur mjekësor.

KONTROLLIME PREVENTIVE TË JASHTËZAKONSHME

- Në kushtet e valëve të nxehta, Specialisti i mjekësisë për punë pavarësisht nga kontrollat e regullta preventive mjekësore, i kryen egzaminimet parandaluese per grupet e ndjeshme të punëtorëve: punëtorë të moshuar, punëtorë me peshë jashtë mase, gratë shtatzëna, të sëmurë kronikë, (sëmundjet kardiovaskulare, endokrine, frysëmarrjes, veshkave, mëlçisë, SNQ, gastrointestinal etj.). Është e nevojshëm qasja individuale e rekomandimeve dhe edukimi si dhe konsultimet me mjekun e përzgjedhur për terapinë e aplikuar ose nevojë për pushim mjekësor.

**SOS NUMER PA PAGESE PER MBROJTJEN E INFORAMCIONEVE NGA VALA
E NXEHTË: 02 / 32 21 902 (1-18h)**

Punimi i materjalit informativ eshte perkrahur nga Organizata boterore e shendetesise, Zyra Shkup



**TA MBROJMË SHËNDETIN E TË
PUNËSUARVE NË KUSHTE TË
VALËS SË NXEHTË**



MINISTRIA E SHËNDËTESISË



Instituti i Shëndetit Publik të RM



Црвен крст на Република Македонија
Крqi i kuq i Republikës së Maqedonisë
Macedonian Red Cross



SPECIALISTI I MJEKËSISË SË PUNËS

DUHET T'I KETË PARASYSH VENDET E PUNËS ME RREZIK TË SHFAQURIT NË TEMPERATURA TË LARTA

- Vende pune në vende të hapura; Punëtorë në ndërtimtari, bujq, kopshtar;
- Punëtorë në komunikacion;
- Punëtorë të cilët punojnë në teren, shitës në tregje të hapura, zjarrfikës, policë, ushtarë etj;
- Vende pune në hapësirë të myllur: të gjitha vendet e punës të cilat nuk janë të klimatizuara dhe ku ka ekspozim në temperaturën e larta dhe rezatim.

Nevojiten aktivitete të koordinuara, të përbashkëta në nivel të ndërmarrjes ku mjeku ka marrëveshje në pajtueshmëri me Ligjin për siguri dhe shëndet gjatë punës (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 92/07).

Aksioni i përbashkët realizohet nëpërmjet bashkëpunimit të specialistit të mjekësisë së punës, punëdhënosit dhe punëtorëve;

Me rolin udhëheqës së specialistit nevojiten aktivitete të jashtëzakonshme: rekomandime, edukim dhe kontrollime preventive;

1. REKOMANDIME PËR PUNËDHËNËSIN

- Kontrollim të masave teknike – teknologjike kolektive për mbrojtje (ventilim adekuat dhe mundësish klimatizim);
- **Kontrollimi të parametrave mikroklimatike;**
- Sigurim të minimum një hapësire të klimatizuar me funksion të "strehimores"
- **Ndryshime në organizimin e procesit punues;**
- Shmangje të punës në të hapur gjatë periudhës më të nxeh të ditës (11 – 17) apo reduktim të saj. Reduktimi i punës së lodhshme fizike; Pauza më të shpeshta gjatë punës, ftohje të punësuarve me sigurim të hapësirave të klimatizuara dhe lëngje për pije;
- **Ulje të intensitetit të punës dhe normave në prodhimtari.** Shmangje të punës jashtë orarit të punës. Ndërprerje të punës sipas nevojës;

- Nxitje të vetparaqitjeve të simptomeve tek të punësuarit;
- **Sigurim të mjeteve adekuate mbrojtëse;**
- Vëmendje me punëtorët vulnerabil (punëtorë më të vjetër, të sëmurë kronik, persona me masë të rëndë trupore të jashtëzakonshme, grashatzëna etj) dhe shpërndarja e tyre;
- Njohja e punëtorëve me rrezikun në vendin e punës nga temperaturat e larta, efektet e mundshme të dëmshme për shëndetin si dhe me masat për punë në mënyrë të sigurt;
- Paralajmërimi i të punësuarve për rrezikun e rritur të fatkeqësive gjatë punës (zjarre). Kujdes dhe mbikqyrje të posaçme gjatë punës me maturie kimike për shkak të rrezikut më të madh nga intoksimi;

2. REKOMANDIME PËR TË PUNËSUARIT

REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

- Regjim të drejtë të ushqyerit me minerale, vitamina të mjaftueshme, më shumë pemë, perime, pa shumë yndyrëra.
- Konsumim të lëngjeve 2l. Ujë në ditë minimum, gjatë kushteve në nxehësi të mëdha rekomandohet marje (1 gotë ujë çdo 20 minuta) pa alkool dhe kofein (për shkak të rrezikut nga dehidrimi); gjatë djerisitjes së shpeshtë dhe aktivitetit intensiv fizik të konsumohet ujë mineral (me dioksidkarboni dhe elektrolite)
- Regjim adekuat të pushimit me pauza të shkurta gjatë punës;
- Gjum të mjaftueshëm;
- Konsumim të barrërave vetëm me konsultimin e mjekut amë
- Ulje të intensitetit të aktiviteteve fizike, dush dhe freskim;
- Njohja e të punësuarve me procesin e aklimatizimit apo adaptimit të organizmit në temperaturën e larta të cilët pjesërisht arrihet për 7 ditë, e në tërësi për 20 ditë.